




Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

Kosovë

Raport vjetor 2023 - 2024

1 janar 2023 - 31 dhjetor 2024

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut – Sekretariati
Rr. Tirana, ndërtesa e Hotelit Derand, kati i 7-të, nr. 6, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 49 78 1680
Email: office@hrrp.eu
www.hrrp.eu

Parathënie

Ky është raporti i katërmbëdhjetë vjetor i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm, “Paneli” ose “PShDNj”), i cili mbulon periudhën nga data 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2024.

Raport është përgatitur nga Paneli dhe i paraqitet Misionit, shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese, si dhe publikut të gjerë, me qëllim të shpërndarjes së informacionit rreth zhvillimit të jurisprudencës dhe aktiviteteve të Panelit.

Gjatë periudhës së raportimit, Paneli ka mbajtur tre (3) seanca dhe ka miratuar dy (2) vendime në dy (2) raste. Në një rast, ankesa u shpall e papranueshme; në tjetrin, u mbyll shqyrtimi i çështjes në lidhje me masat e përkohshme të kërkuara nga ankuesi. Paneli gjithashtu ndryshoi rregulloren e punës për të siguruar procedimin e duhur të kërkesave për masa të përkohshme.

Në prill 2023, një anëtar i ri i jashtëm iu bashkua Panelit, duke plotësuar pozitën e lirë të punës që kishte ekzistuar që nga viti 2021. Përveç kësaj, në dhjetor 2023, u emërua një anëtar i ri zëvendësues.

Megjithatë, funksionimi i Panelit u ndikua seriozisht për shkak të largimit të zyrtarit ligjor, gjë që e bëri Sekretariatin jo-funksional nga nëntori 2023 deri në gusht 2024. Pozita e përkthyesit/interpretit serbisht-anglisht ishte gjithashtu e lirë nga muaji qershor deri në muajin shtator 2024.

Gjatë periudhës së raportimit, nuk u regjistruan ankesa të reja. Që nga data 31 dhjetor 2024, numri i lëndëve në pritje ishte njëzet e dy (22) raste. Nga këto, njëzet (20) raste lidhen me zhdukjet të dhunshme gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë gjatë viteve 1998-1999; dy rastet e tjera (2) kanë të bëjnë, përkatësisht me të drejtën për mjete juridike efektiv dhe të drejtat e dëshmitarëve të mbrojtur dhe familjeve të tyre.

Marina Mancini

Ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	1
1. Korniza rregulluese	4
1.1. Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit ‘EULEX-i Kosovë’	4
1.2. Vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/856 i datës 8 qershor 2018	4
1.3. Koncepti i Llogaridhënies EULEX-i Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, 29 tetor 2009	4
1.4. Instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme të të drejtave të njeriut.....	5
1.5. Rregullorja e punës.....	5
1.6. Përpunimi i përshpejtuar i lëndëve	6
2. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave	6
2.1. Numri i lëndëve dhe statistikat	6
2.2. Subjekti i ankesave	8
2.3. Seancat e Panelit	8
3. Jurisprudenca.....	9
3.1. Hyrje	9
3.2. Vendimi mbi pranueshmërinë.....	9
3.3. Vendimi mbi zbatimin e një kërkesë për marrjen e masave të përkohshme	9
4. Aktivitete të tjera të Panelit.....	9
4.1. Takimet.....	9
4.2. Fushata informuese.....	10
4.3. Trajnimi hyrës.....	10
4.4. Faqja e internetit e PShDNj-së	10
5. Paneli dhe Sekretariati.....	11
5.1. Anëtarët e Panelit.....	11
5.1.1. Kryesuesja e Panelit.....	11
5.1.2. Anëtarët që nga data 31 dhjetor 2024	11
5.2. Sekretariati	13
6. Buxheti	13
7. Përfundime dhe rekomandime.....	14
SHTOJCA 1 Statistikat 2010 - 2024	15
SHTOJCA 2 - TABELA E SHKELJEVE DHE VENDIMET PASUESE – 31 dhjetor 2024.....	16

1. Korniza rregulluese

Baza ligjore për funksionimin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë (në tekstin e mëtejme “Misioni”), rrjedh përgjithësisht nga Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e datës 10 qershor 1999, dhe rrjedh posaçërisht nga vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian. Këto vendime të Këshillit shërbejnë për të zbatuar Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) të Bashkimit Evropian.

1.1. Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit ‘EULEX-i Kosovë’

Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP është burimi i autoritetit dhe kompetencës së Misionit të EULEX-it Kosovë. Ai përcaktoi mandatin e EULEX-it Kosovë dhe, *ndër të tjera*, specifikoi përgjegjësinë e tij për të vepruar në përputhje me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut në nenin 3 (i): *“siguron që të gjitha aktivitetet e tij të respektojnë standardet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut dhe përfshirjen gjinor”*.

1.2. Vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/856 i datës 8 qershor 2018

Në mandatin e tij aktual, siç është ndryshuar nga vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/856, Misioni monitoron raste dhe gjykime të përzgjedhura në institucionet e drejtësisë penale dhe civile të Kosovës. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, rastet që iu dorëzuan institucioneve kompetente të Kosovës. Për më tepër, EULEX-i Kosovë mban një numër të kufizuar kompetencash ekzekutive në lidhje me, ndër të tjera, mbrojtjen e dëshmitarëve, inteligjencën penale kriminale dhe ruajtjen e rendit publik, si reagues i dytë i sigurisë pas autoriteteve vendore.

1.3. Koncepti i Llogaridhënies EULEX-i Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, 29 tetor 2009

Krijimi i një mekanizmi të pavarur, efektiv dhe transparent të llogaridhënies për të drejtat e njeriut u identifikua në fillim të funksionimit të Misionit si një kërkesë themelore për EULEX-in Kosovë si Mision i Sundimit të Ligjit me funksione të caktuara ekzekutive. Këto funksione ekzekutive përfshinin funksione të ndryshme në polici dhe ndjekje penale të rezervuara për zyrtarët e EULEX-it në lidhje me ruajtjen e rendit publik, hetimin dhe ndjekjen penale, veçanërisht të krimeve të luftës dhe kriminit të organizuar, dhe ndihmën në antropologjinë mjeko-ligjore. Një mekanizëm i tillë i jashtëm për llogaridhënie kishte për qëllim të plotësonte dhe shtonte në llogaridhënien e përgjithshme të EULEX-it Kosovë, siç parashikohet nga skema e sigurimit të përgjegjësisë ndaj palës së tretë dhe mekanizmi i brendshëm disiplinor i EULEX-it.

Kështu, Koncepti i Llogaridhënies përcaktoi mandatin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut *për të shqyrtuar ankesat nga çdo person, përveç personelit të EULEX-it Kosovë, i cili pretendon të jetë viktimë e ndonjë shkeljeje të të drejtave të tij ose të saj të njeriut nga EULEX Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv*.¹

¹ Koncepti i Llogaridhënies është pjesë e Planit Operacional të EULEX-it. Prandaj, ai konsiderohet si dokument i kufizuar dhe për këtë arsye nuk është i qashtëm për publikun. Paneli nuk mund të zbulojë hollësitë e tij.

Megjithatë, në përputhje me Konceptin e Llogaridhënies, Paneli nuk ka juridiksion sa i përket gjykatave të Kosovës. Fakti që gjyqtarët e EULEX-it ishin pjesë e një gjykate të caktuar nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës.

Paneli miratoi Rregulloren e vet të Punës më 10 qershor 2010, datë prej kur ishte i autorizuar të pranonte ankesa. Ai i ndryshoi rregullat më 21 nëntor 2011, 15 janar 2013, 15 janar 2019, 11 dhjetor 2019 dhe përsëri më 6 korrik 2023.

1.4. Instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme të të drejtave të njeriut

Në përputhje me dispozitat e Konceptit të Përgjegjshmërisë, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara të instrumenteve përkatëse të të drejtave të njeriut, duke përfshirë me sa vijon:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948)
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ, 1950)
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD, 1965)
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR, 1966)
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR, 1966)
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW, 1979)
- Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (CAT, 1984)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës (CRC, 1989)

Në praktikë, ankesat e paraqitura deri më sot janë bazuar kryesisht në KEDNJ dhe Protokollet e saj. Një numër ankesash i janë referuar gjithashtu Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ICCPR, ICESCR dhe instrumenteve të tjera të të drejtave të njeriut. Në disa ankesa, janë bërë referenca edhe në jurisprudencën e Gjykatës Ndëramerikane të të Drejtave të Njeriut, Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale.

1.5. Rregullorja e punës

Pas hyrjes në fuqi më 15 qershor 2018 të Vendimit të Këshillit (CFSP) 2018/856, mandati dhe përbërja e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut u ndryshuan. Për të reflektuar këto ndryshime, rregullorja e punës gjithashtu duhej të ndryshohej.

Më 15 janar 2019, Paneli miratoi rregulloren e ndryshuar të punës për të marrë parasysh ndryshimin në mandatin e Misionit dhe nevojën për të reformuar Panelin.

Më 11 dhjetor 2019, Paneli miratoi një ndryshim në rregulloren 43 të rregullores së punës, për t'u mundësuar të dyja palëve në një ankesë të mund të paraqesin kërkesë për rishikimin e gjetjeve të një vendimi të Panelit, në rrethana kur informacione të reja do të kishin dalë në dritë kur nuk ishin të disponueshme në kohën kur Paneli kishte marrë vendimin e tij fillestar.

Më 6 korrik 2023, Paneli ndryshoi rregullën 22 të rregullores së punës në lidhje me masat e përkohshme. Sipas rregullës 22 të ndryshuar, shefi i Misionit duhet të njoftojë Panelin për vendimin e tij/saj në lidhje me kërkesën për masa të përkohshme; më pas Paneli do të miratojë një vendim lidhur me përgjigjen e shefit të Misionit dhe zbatimin e çfarëdo mase të përkohshme: ai mund të mbyllë çështjen e masave të përkohshme ose të mbetet i angazhuar në të, derisa të merret një vendim mbi pranueshmërinë dhe/ose meritat e ankesës.

Rregullorja e punës gjendet në anglisht, shqip dhe serbisht në faqen e internetit të Panelit, në <https://hrrp.eu/alb/reference-documents.php>.

1.6. Përpunimi i përshpejtuar i lëndëve

Nga fundi i vitit 2020, për të përshpejtuar përpunimin e lëndëve në pritje, si rregull i përgjithshëm Paneli merret me çështjet e pranueshmërisë dhe meritave njëkohësisht në një vendim të vetëm.

2. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave

2.1. Numri i lëndëve dhe statistikave


Që nga 1 janari 2023, numri i lëndëve në pritje ishte njëzet e tre (23) raste.

Paneli nuk mori asnjë ankesë të re në vitin 2023 ose vitin 2024.


Gjatë vitit 2023, Paneli përfundoi një (1) lëndë, duke e shpallur atë të papranueshme.

Përveç kësaj, në një lëndë tjetër Paneli vendosi të mbyllë shqyrtimin e lëndës në lidhje me masat e përkohshme të kërkuara nga ankuesi, pa paragjykuar pranueshmërinë dhe meritat e ankesës.


Numri i lëndëve në pritje më 31 dhjetor 2024 ishte njëzet e dy (22) raste.




Statistikat e lëndëve 2023-2024



LËNDËT E PËRFUNDUARA - 31 DHJETOR 2024



NUMRI I LËNDËVE GJITHSEJ - 31 DHJETOR 2024



Vini re se disa raste përfshinin ankesa të shumëfishta, jo të gjitha prej të cilave ishin (të pa)pranueshme.

2.2. Subjekti i ankesave

Shumica e ankesave që ishin duke u shqyrtuar nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në vitet 2023 dhe 2024 kishin të bënin me raste të zhdukjeve të dhunshme, të cilat kishin ndodhur gjatë ose menjëherë pas konfliktit të viteve 1998-1999 në Kosovë. Ankesat kryesisht kanë të bëjnë me shkelje të dyshuara të së drejtës për jetë sipas pjesës së saj procedurale dhe të drejtës për mos t’iu nënshtruar torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, për shkak të vuajtjeve të shkaktuara nga zhdukja dhe mungesa e një hetimi efektiv, siç garantohet nga nenet 2 dhe 3 të KEDNJ-së. Lidhur me këto raste, Paneli vazhdoi të ndiqte zbatimin e rekomandimeve të tij nga shefi i Misionit.

Një nga ankesat e shqyrtuara në vitin 2023 kishte të bënte me kushtet e paraburgimit të një njeriu të akuzuar për krime lufte, i cili ishte arrestuar nga policia e Kosovës në vitin 2019 dhe ishte liruar nga Gjykata Supreme e Kosovës në vitin 2022. Paneli e shpalli ankesën të papranueshme pasi ajo binte jashtë juridiksionit të tij sipas rregullave 25(1) dhe 29(1)(d) të rregullores së tij të punës.

Një ankesë tjetër e shqyrtuar gjatë periudhës raportuese kishte të bënte me një dëshmitar të mbrojtur dhe ndikimin e statusit të tij tek ai vetë dhe familja e tij. Në vitin 2022, pas kërkesës së ankuesit, ushtruesi detyrës së kryesueses së Panelit i kishte propozuar shefit të Misionit marrjen e masave të përkohshme gjatë shqyrtimit të lëndës, në mënyrë që të garantohej siguria e ankuesit dhe familjes së tij. Në vitin 2023, Paneli shqyrtoi përgjigjen nga shefi i Misionit dhe vendosi të përfundonte shqyrtimin e çështjes, pa paragjykuar pranueshmërinë dhe meritat e ankesës.

2.3. Seancat e Panelit

Gjatë vitit 2023, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut mbajti dy (2) seanca. Seanca e parë u mbajt me pjesëmarrje fizike në Prishtinë, ndërsa seanca e dytë u zhvillua përmes mjeteve elektronike, siç autorizohet nga Rregulli 13(3) i rregullores së punës.

- Seanca e 55-të: 4-7 korrik 2023
- Seanca e 56-të: 10 gusht 2023

Gjatë vitit 2024, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut mbajti një (1) seancë me pjesëmarrje fizike në Prishtinë.

- Seanca e 57-të: 10-12 dhjetor 2024

3. Jurisprudenca

3.1. Hyrje

Gjatë periudhës së raportimit, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut vazhdoi të zhvillonte jurisprudencën e tij dhe nxori dy vendime, njërin në lidhje me pranueshmërinë dhe tjetrin në lidhje me zbatimin e një kërkesë për masa të përkohshme.

Për më tepër, Paneli ka vazhduar të monitoronte zbatimin e rekomandimeve të tij nga ana e Misionit në rastet e mëposhtme: 2011-20, 2016-09, 2016-10, 2016-11, 2016-12, 2016-13, 2016-14, 2016-15, 2016-17, 2016-19, 2016-20, 2016-21, 2016-22, 2016-23, 2016-24, 2016-28, 2016-29, 2016-30, 2016-32, 2017-02. Aftësia e Panelit për t'i përcjellë rekomandimet e tij është një element i rëndësishëm i infrastrukturës së tij normative, pasi i mundëson Panelit të sigurojë që rekomandimet të merren në konsideratë siç duhet dhe plotësisht nga Misioni dhe që ato të zbatohen në masën më të madhe të mundshme.

3.2. Vendimi mbi pranueshmërinë

Paneli nxori një (1) vendim mbi (pa)pranueshmërinë gjatë seancës së tij të 55-të.

- *Lënda 2021-01 N.M. kundër EULEX-it.* Më 6 korrik 2023, Paneli e shpalli këtë rast të papranueshëm. Ankuesi pretendoi se të drejtat e tij të njeriut ishin shkelur për shkak të arrestimit të tij nga policia e Kosovës në vitin 2019 dhe paraburgimit të mëvonshëm për akuza për krime lufte, deri në lirim të tij nga Gjykata Supreme e Kosovës në vitin 2022. Paneli e shpalli këtë ankesë të papranueshme sepse ngjarjet për të cilat pati ankesë nuk i ngarkoheshin EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv dhe për këtë arsye nuk hynin brenda fushëveprimit të juridiksionit të Panelit.

3.3. Vendimi mbi zbatimin e një kërkesë për marrjen e masave të përkohshme

Paneli nxori një (1) vendim mbi zbatimin e një kërkesë për masa të përkohshme gjatë seancës së tij të 56-të.

- *Lënda 2021-02 O.L. dhe të tjerë kundër EULEX-it.* Më 10 gusht 2023, Paneli vendosi të mbyllë shqyrtimin e lëndës në lidhje me masat e përkohshme të kërkuara nga ankuesi, i cili ishte regjistruar në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve të EULEX-it në vitin 2013. Në vitin 2022, ushtruesi i detyrës së kryesueses së Panelit i kishte propozuar shefit të Misionit marrjen e masave të përkohshme gjatë shqyrtimit të lëndës, në mënyrë që të garantohej siguria e ankuesit dhe familjes së tij. Në vitin 2023, Paneli shqyrtoi përgjigjen nga shefi i Misionit dhe vendosi të përfundonte shqyrtimin e çështjes, pa paragjykuar pranueshmërinë dhe meritat e ankesës.

4. Aktivitete të tjera të Panelit

4.1. Takimet

Më 4 korrik 2023, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut u takua me z. Giovanni Pietro Barbano, Shefin e Misionit të EULEX-i Kosovë. Anëtarët e Panelit ia prezantuan veten dhe punën e Panelit shefit të sapoardhur të Misionit.

4.2. Fushata informuese

Dokumenti Konceptual i Llogaridhënies i 29 tetorit 2009 ka deklaruar, ndër të tjera, në paragrafin E, se, “...EULEX-i Kosovë do të sigurojë një shpërndarje të duhur të informacionit publik në lidhje me Panelin dhe punën e tij...”

Komandanti i Operacioneve Civile, në udhëzimin e tij të 13 nëntorit 2009, ka deklaruar në lidhje me Panelin, se Udhërrëfyesi për Kapacitetin e Veprimtarisë Civile duhet të përfshijë, “...përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse të marrëdhënieve me publikun”.

Tre video informuese janë të disponueshme në faqen e internetit dhe llogarinë në Facebook të Panelit. Ato u publikuan në vitin 2020 dhe 2021, në anglisht, shqip dhe serbisht, për të ofruar informacion bazë rreth Panelit dhe punës së tij.

Ato mbulojnë temat e mëposhtme:

1. Hyrje në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
2. Si mund të paraqisni ankesë në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut?
3. Çfarë bën Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut me ankesën tuaj?

4.3. Trajnimi hyrës

Gjatë periudhës raportuese, Sekretariati vazhdoi ndihmën e tij për programin e trajnimit hyrës të EULEX-it për anëtarët e stafit të ardhshëm, përveç rasteve kur pozicioni i zyrtarit ligjor ishte i lirë (nga 14 nëntori 2023 deri më 27 gusht 2024). Format i përbëhet nga një prezantim mbi punën e Panelit me kohë të ndarë për pyetje dhe përgjigje. Ky proces është i dobishëm për të informuar anëtarët e rinj të stafit mbi mandatin e Panelit, për të nënvizuar më tej rëndësinë e pajtueshmërisë me të drejtat e njeriut për EULEX-i Kosovë dhe për të rritur profilin e Panelit me anëtarët e stafit të EULEX-it në fushën e operacioneve të Misionit. Ky është një element i rëndësishëm në procesin e sigurimit që personeli i EULEX-it të jetë i vetëdijshëm për detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut dhe të mund të veprojnë në përputhje me to.

4.4. Faqja e internetit e PShDNj-së

Sekretariati mirëmban faqen e internetit të Panelit (<https://www.hrrp.eu/alb/>) dhe llogarinë në Facebook (Human Rights Review Panel), në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe.

Faqja e internetit e PShDNj-së ofron informacion mbi mandatin, procedurat dhe operacionet e Panelit. Gjithashtu përmban informacion të përditësuar rregullisht mbi vendimet e Panelit, si dhe listën e lëndëve në pritje dhe të përfunduara.

Tabela e jurisprudencës së Panelit është lehtësisht e qasshme. Ajo rendit jurisprudencën në rritje të Panelit sipas temës, si për pranueshmërinë ashtu edhe për meritën e lëndëve në shqyrtim. *Ndër të tjera*, kjo u krijua për të ofruar qasje të gatshme dhe të lehtë për përdorim në jurisprudencën e Panelit për ankuesit, avokatët dhe publikun e gjerë (<https://hrrp.eu/alb/jurisprudence.php>).

Shënimet e Jurisprudencës janë gjithashtu të disponueshme. Ato përmbledhin sipas temës disa nga aspektet më të rëndësishme të jurisprudencës së Panelit (https://hrrp.eu/Case-Law_Notes.php).

Faqja e internetit e PShDNj-së gjithashtu ofron informacion rreth:

- Standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut (<https://hrrp.eu/alb/relevant-rights.php>).
- Si të bëni një ankesë (<https://hrrp.eu/alb/complaints.php>).

5. Paneli dhe Sekretariati

5.1. Anëtarët e Panelit

Sipas Konceptit të Llogaridhënies dhe rregullores së punës së Panelit, Paneli përbëhet prej katër anëtarëve; dy anëtarë të jashtëm dhe dy anëtarë të EULEX-it, prej të cilëve njëri është zëvendës i tjetrit. Para rishikimit të mandatit në qershor të vitit 2018, të dy anëtarët e EULEX-it ishin pjesëtarë të EULEX-it të emëruar për të punuar si gjykatës në sistemin gjyqësor të Kosovës. Pas rishikimit të mandatit, të dy anëtarët e EULEX-it janë pjesëtarë të Shtyllës së Monitorimit të EULEX-it.

5.1.1. Kryesuesja e Panelit

Më 5 korrik 2023, znj. Snježana Bokulić u zgjodh zyrtarisht kryesuese e Panelit. Ajo mbajti këtë pozicion gjatë gjithë viteve 2023 dhe 2024.²

5.1.2. Anëtarët që nga data 31 dhjetor 2024

Znj. Snježana Bokulić – Anëtare e jashtme, kryesuese e Panelit, e emëruar më 6 dhjetor 2021.

Snježana Bokulić është avokate e të drejtave të njeriut, e cila ka punuar në organizata ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare për më shumë se dy dekada duke zbatuar ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut për të avancuar respektimin e të drejtave të njeriut të komuniteteve në pesë kontinente. Është e specializuar në të drejtat e pakicave, të drejtat e popujve indigjenë, mos diskriminimin dhe ndërsektorialitetin. Ajo ka punuar gjerësisht në llogaridhënien e organizatave dhe krijimin e mekanizmave të ankesave të organizatave.

Si shefe e departamentit të të drejtave të njeriut të OSBE/ODIHR-it, znj. Bokulić ka drejtuar misione të vlerësimit të të drejtave të njeriut të ODIHR-it në Ukrainë dhe në bazën detare të Guantanos, si dhe misionin e monitorimit të gjyqësorit në Bjellorusi. Ajo ka udhëhequr programin e monitorimit të lirisë së tubimeve paqësore të ODIHR-it dhe ka udhëhequr hartimin e udhëzimeve të ODIHR-it për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Ajo është kryetare e Panelit të Pavarur për Shqyrtim në Accountable Now, një platformë globale e anëtarësimit që synon të rrisë llogaridhënien në organizata të shoqërisë civile, dhe është anëtare e Këshillit të the3million, organizatës më të madhe me bazë në komunitet të qytetarëve të BE-së në Mbretërinë e Bashkuar.

Znj. Bokulić mban titullin e masterit në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nga Universiteti i Essex-it, po ashtu mban titullin e masterit në studimet e Evropës Juglindore nga Universiteti i Evropës Qendrore dhe diplomë të studimeve themelore nga Kolegji Notre Dame në Maryland.

Shefi i Misionit të EULEX-it ka emëruar znj. Bokulić anëtare të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut më 6 dhjetor.

² Pas përfundimit të mandatit të znj. Bokulić më 14 qershor 2025, znj. Marina Mancini mori rolin e ushtrueses së detyrës së kryesueses së Panelit.

Ms Marina Mancini, anëtare e jashtme, e emëruar më 3 prill 2023.

Znj. Marina Mancini është profesoreshë e asociuar e së drejtës ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar të Reggio Calabria-s, ku ajo gjithashtu ligjeron ligjin e Bashkimit Evropian (që nga viti 2015). Ajo është gjithashtu profesoreshë e asociuar e së Drejtës Penale Ndërkombëtare në Universitetin LUISS, në Romë (që nga viti 2007).

Znj. Mancini ka botuar gjerësisht në fushat e së drejtës së të drejtave të njeriut, të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës penale ndërkombëtare. Ajo është autore e librave “Stato di guerra e conflitto armato nel diritto internazionale” [Gjendja e luftës dhe konflikti i armatosur në të drejtën ndërkombëtare] (Torino, Giappichelli, 2009) dhe “Statualità e non riconoscimento nel diritto internazionale” [Shtetësia dhe mosnjoha në të drejtën ndërkombëtare] (Torino, Giappichelli, 2020). Ajo është gjithashtu anëtare e këshillit të redaktorëve të librit vjetor italian të së drejtës ndërkombëtare.

Znj. Mancini ka përvojë të konsiderueshme në projekte kërkimore të financuara në fushat e të drejtës së të drejtave të njeriut, të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës penale ndërkombëtare. Aktualisht, ajo është hetuesja kryesore e projektit kërkimor “Avancimi i llogaridhënies për krimet ndërkombëtare përmes juridiksionit universal: Sfidat për Bashkimin Evropian dhe shtetet e tij anëtare dhe propozimet për veprim (UNIJUR)” (2023-2025), i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të instrumentit të rimëkëmbjes NextGenerationEU. Ajo gjithashtu shërbeu si anëtare italiane e Komitetit Menaxhues të Veprimit COST CA18228 - Global Atrocity Justice Constellations (2019-2023).

Znj. Mancini ka diplomuar në fakultetin juridik, duke u diplomuar me vlerësimin më të lartë (*summa cum laude*) nga Universiteti LUISS në vitin 1998, dhe mori titullin doktor në të Drejtën Ndërkombëtare nga Universiteti Sapienza i Romës, në vitin 2003. Ajo ndoqi studimet pasdoktorale në të Drejtën Ndërkombëtare në Universitetin LUISS (2003-2005) dhe ishte ligjeruese e lartë në të Drejtën Ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar të Reggio Calabria (2005-2015).

Ajo u pranua në Dhomën e Avokatëve të Romës (Ordine degli Avvocati di Roma) në vitin 2002 dhe ofron rregullisht këshilla në lidhje me çështjet e së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë shkeljet e të drejtave të njeriut.

Znj. Mancini u emërua anëtare e Panelit për Shqyrtimit e të Drejtave të Njeriut nga shefi i Misionit të EULEX-it Kosovë më 3 prill 2023.

Z. Petko Petkov – Anëtar zëvendësues i EULEX-it, i emëruar më 19 dhjetor 2018, dhe anëtar i EULEX-it, i emëruar që nga data 1 dhjetor 2023.

Z. Petko Petkov ka diplomuar në Universitetin e Sofjes me titullin e magjistratit të shkencave juridike. Ai ka shërbyer gjyqtar ndihmës në Gjykatën e Rrethit të Sofjes nga viti 2005 deri në vitin 2007 dhe që nga viti 2007 është gjyqtar në Divizionin Penal në Gjykatën Rajonale të Sofjes. Gjatë karrierës së tij si gjykatës penal ka punuar në mijëra raste dhe thelbi i punës së tij ka qenë t’iu përmbahet gjithmonë parimeve të KEDNj-së dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga viti 2014 deri në fund të vitit 2015 ai u emërua ekspert për zëvendësministrin e Drejtësisë të Republikës së Bullgarisë. Gjatë kësaj periudhe ai ishte përgjegjës për përfaqësimin e vendit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe duhej të ofronte udhëzime metodologjike dhe kontroll mbi veprimtarinë e drejtorisë brenda Ministrisë. Përveç detyrave që kanë të bëjnë me përcaktimin e mënyrës së veprimit (*modus operandi*) të përfaqësimit procedural pranë GjEDNj-së, ai ishte i përfshirë drejtpërdrejt në hartimin e ndryshimeve legjislative në lidhje me gjyqësorin.

Prej vitit 2012 deri në vitin 2015 ai ka qenë ligjërues mysafir i së Drejtës Penale në Institutin Kombëtar të Trajnimit për Gjyqësorin, ku ka zgjeruar dhe zhvilluar njohuritë e tij në një nivel më teorik dhe akademik.

Ai iu bashkua EULEX-it Kosovë në vitin 2017 si gjyqtar penal ndërkombëtar, ku ka punuar deri në fund të mandatit ekzekutiv të Misionit në vitin 2018. Aktualisht është vëzhgues tematik në fushën e krimeve sipas ligjit ndërkombëtar në EULEX Kosovë.

Z. Petkov ishte emëruar anëtar zëvendësues i Panelit për Shqrtimin e të Drejtave të Njeriut më 19 dhjetor 2018 dhe u bë anëtar i plotë i Panelit që nga data 1 dhjetor 2023.

Znj. Henna Maria Niemi – Anëtare zëvendësuese e EULEX-it, e emëruar më 1 dhjetor 2023.

Znj. Niemi u diplomua në Universitetin e Laplandës në shkallën e masterit në shkencat juridike në vitin 2008. Ajo punoi si gjyqtare praktikante e Gjykatës së Qarkut në vitet 2009-2010 dhe në Gjykatën e Apelit me disa poste që nga viti 2014. Përveç kësaj, ajo punoi në Universitetin e Laplandës si studiuese duke kryer kërkime në disa fusha të ligjit, duke përfshirë ligjin ndërkombëtar dhe të të drejtave të njeriut.

Znj. Niemi iu bashkua EULEX-i Kosovë në vitin 2022 si Monitoruese Kryesore Tematike për Krimet e Urrejtjes. Ajo u emërua anëtare zëvendësuese e EULEX-it e Panelit të Shqyrtimit të të Drejtave të Njeriut më 1 dhjetor 2023.

5.2. Sekretariati

Sekretariati ofron mbështetje ligjore dhe administrative, si dhe shërbime gjuhësore për Panelin. Gjithashtu pranon parashtrues të ankesave (potenciale) dhe siguron komunikim dhe korrespondencë midis Panelit dhe parashtruesve të ankesave, si dhe shefit të Misionit. Përveç kësaj, Sekretariati lehtëson kontaktimin me të gjitha komunitetet në Kosovë.

Sekretariati përbëhet nga një zyrtar ligjor dhe dy përkthyes/interpret. Ai është i vendosur në ambiente të dedikuara ku ndodhet administrata, të dhënat dhe arkivat e tij, pavarësisht nga lokacionet e tjera të EULEX-it Kosovë.

Gjatë periudhës së raportimit, pozita e zyrtarit ligjor ishte e lirë nga data 14 nëntor 2023, kur përfundoi emërimi i z. Ronald Hooghiemstra, deri më 27 gusht 2024, kur znj. Pia Holm mori pozitën. Kjo e bëri Sekretariatin jo-operacional për më shumë se nëntë muaj.

Pozicioni i përkthyesit/Interpretit serbisht-anglisht ishte gjithashtu i lirë nga qershori deri në shtator 2024, fatkeqësisht për shkak të vdekjes së znj. Katica Kovacevic, e cila e kishte mbajtur këtë pozitë që nga viti 2010. Në tetor 2024, znj. Xhenana Azizi u emërua në këtë pozitë.

Lidhur me pozicionin e përkthyesit/interpretit shqip-anglisht, z. Kushtrim Xhaferi vazhdoi ta mbante këtë rol gjatë gjithë periudhës së raportimit.

6. Buxheti

Paneli posedon një buxhet të pavarur, megjithëse kërkesat e tij modeste për shpenzime miratohen nga Misioni sipas rastit. Gjatë periudhës së raportimit, Paneli nuk bëri asnjë kërkesë për shpenzime.

7. Përfundime dhe rekomandime

Gjatë periudhës së raportimit, aftësia e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut për të kryer punën e tij u ndikua rëndë nga vonesat e zgjatura në rekrutimin e një zyrtari të ri ligjor, gjë që rezultoi në mosfunksionimin e Sekretariatit për më shumë se nëntë muaj. Ndër të tjera, kjo pengoi shqyrtimin e një lënde komplekse që kishte të bënte me të drejtat e njeriut të një dëshmitari të mbrojtur dhe familjes së tij, dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Panelit nga Misioni në lidhje me më shumë se njëzet raste që janë ende në fazën e përcjelljes.

Që nga 31 dhjetori 2024, shumica e rasteve në pritje janë raste të zhdukjeve të dhunshme të ilustruara tashmë në raportet e mëparshme vjetore. Lidhur me to, Paneli shpreh veçanërisht keqardhje për vendimin e Misionit, të përsëritur në një letër të datës 3 tetor 2023, për të mos pranuar shkeljet e të drejtave të njeriut që i ngarkohen EULEX-it dhe kërkon rishqyrtimin e këtij vendimi. Një pranim i tillë publik nga Misioni do të ishte një pjesë thelbësore e detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut sipas Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP dhe do të ndihmonte në një farë mënyre drejt korrigjimit të shkeljeve të identifikuara nga Paneli.

